



sameda[®]
ORTHOPAEDIC PRODUCTS

Gjithçka që ju duhet të dini rreth përdorimit të ortozës ALFA-Flex ose BETA-Flex ...



Informata
per Prindërit





Të nderuar Prindër,

Trajtimi momental i fëmijës tuaj me metodën Ponseti ka bërë mrekulli. Nëse jeni duke e filluar trajtimin me ortozën ALFA-Flex ose BETA-Flex, atëherë këmba apo shputa e fëmijës tuaj tanimë është përmirësuar me sukses. Për të vazhduar kështu dhe që fëmija juaj të mund të ec si të gjithë fëmijët tjerë, ai/a jo ka nevojë për ortozën abdukcionale e shputës dhe për ndihmën tuaj.

Për një fillim optimal me ortozën , ne kemi përmbledhur informatat më të rëndësishme për përdorimin dhe zgjidhjen e problemit.

Ju urojmë ju dhe fëmijës suaj një familjarizim të shpejtë dhe zhvillim të kënaqshëm në vazhdimësi.

A handwritten signature in black ink that reads "H. Kujus". The signature is fluid and cursive.

Harald Kujus
Drejtore Menaxhues
Semeda GmbH

Pse të përdoret ortoza – shputa duket mirë?

Ortoza abdukcionale e shputës përdoret vetëm pasi që këmba e shtrembër është përmirësuar tërësisht me manipulime dhe korigjime me gips. Edhe pas përmirësimit të plotë, këmba e shtrembër ka tendencë të rikthehet deri në moshën 4 – 5 vjeçare. Ortoza abdukcionale e shputës është momentalisht e vetmja metodë e suksesshme që përdoret për parandalimin e rikthimit. Duke ndjekur programin e terapise Ponseti, rikthimi i këmbës së shtrembër parandalohet me sukses deri në 90% të fëmijëve. Në mënyrë që të vërehet sa më heret dhe të trajtohet rikthimi i mundshëm, është me rëndësi që ju të vazhdoni kontrollat e rregullta te mjeku tuaj.

Programi i terapise – Sa gjatë duhet fëmija im të mbajë ortozen?

Në momentin e fillimit të terapisë me ortoza, fëmija duhet t'a mbajë **23 orë në ditë gjatë 3 muajve**. Pas kësaj kohe periudha ditore e mbajtjes së ortoza mund të reduktohet në **14 orë në ditë**, përdorisa mjeku nuk udhëzon ndryshe. Është e këshillueshme të përdoret gjatë gjumit, poashtu gjatë gjumit të pasditës. Në përgjithësi terapia me ortoza duhet të vazhdohet deri në moshën 4 ose 5 vjeçare, varësisht nga vlerësimi i mjekut tuaj.



Vendosja e ortozës – Si bëhet?

Kur të merrni ortozën nga mjeku juaj apo nga tekniku ortopedik, ai/ajo do të rregulloj këndet dhe gjatësinë e ortozës.

Ju lutemi në asnjë mënyrë mos t'i ndryshoni këto, këto janë shumë të rëndësishme për terapi. Tani është puna juaj t'ia vendosni fëmijës, siç shihet në foto. Kur të merrni ortozën lejoni mjekun apo teknikun ortopedik të ju shpjegoj përdorimin preciz të saj. Nëse gjatë ditëve të para keni ndonjë pyetje ju lutemi mos hezitoni dhe pyetni prapë, sepse është me rëndësi që ju dhe fëmija juaj të ndiheni rehat.



1

Mbathni fëmijës çorapë. **Kurrë mos përdorni këpucën në këmbë të zbatthur!** Hapni të gjithë mbërthyesit e këpucës.



4

Tërhiq çorapën nga gishtat në mënyrë që të largohen rrudhat e çorapës. Pastaj mbyll mbërthyesit tjerë të këpucës, dhe të njëjtat hapa përsërit te këpuca tjetër.



2

Fute këmbën ashtu që themra të jetë e vendosur deri në fund (tek vrima inspektuese). Kjo është me rëndësi në mënyrë që këpuca të jetë e mbathur si duhet.



5

Për të vendosur ortozën në këpucë, duhet futur mbërthyesit dhëmbëzues të ortozës në vrimat përfundi këpucës dhe të shtyhen në drejtim të themrës derisa të bllokohet në ngushticën e vrimës.



3

Së pari, mbylle mbërthyesin e mesëm. Duhet të jetë e shtrenguar, sepse kjo e mban themren në poziten e duhur.



6

Nëse të dy këpucët janë të ngjitura, atëherë fëmija juaj duhet të shohë arinjtë ose përkatësisht delfinin në drejtimin e duhur.

Vendosja e ortozës në fillim do të jetë paksa e pazakonshme për ju. Megjithatë, pas një kohe, do të ju bëhet zakon dhe do të përvetësoni mënyra sa më të përshtatshme për vendosjen e ortozës tek fëmija juaj. Pastaj mbathja e këpucëve dhe vendosja e ortozës nuk do të iu marrin shumë kohë vetëm disa minuta.

Edhe diçka tjetër e rëndësishme për t'u ditur?

Koha për t'u mësuar: Ortoza është e panjohur për fëmijën tuaj në fillim të terpisë. Lëkura është ende e ndjeshme pas gipsit dhe lëvizja e këmbëve është e kufizuar. Kjo edhe shpesh shakton ndjenjë të parehatshme në ditët e para të terapisë, qajnë më shumë se zakonisht dhe nuk flejnë mirë. Mos u shqetësoni nga kjo. Zakonisht fëmijët mësohen me ortozën mbrenda dy apo tri ditëve të para të terapisë. Është e rëndësishme që të jeni këmbëngulës në çdo rast (vetëm nëse vëreni skuqje të dukshme- shiko më poshtë: Çfarë probleme mund të shfaqen?) Nëse ortoza vendoset rregullisht, fëmijës do t'i duket normale.

Megjithatë, nëse fëmija juaj mbrenda 2-3 ditëve të para nuk është mësuar ende me ortozën, p.sh. ai/ajo qanë shpesh, zgjohet shpesh nga gjumi dhe është irrituese për një kohë të gjatë, ju duhet të kontaktoni mjekun tuaj për një kontroll. Megjithatë në trajtimin BETA-Flex ndryshe nga ALFA-Flex, këto fenomene janë edhe më të rralla për shkak të lirisë më të madhe në lëvizje.

Përmirësim: Ortoza nuk e pengon zhvillimin e fëmijës. Do të shihni, për shembull, fëmija do të ecë këmbadoras apo edhe të ngritet në këmbë me ortozë, kur e arrin moshën e duhur.

Rregullimi i ortozës: Zakonisht, në fillim ortoza abdukcionale rregullohet në kënd 70° (abdukcion) për këmbë të shtrembër dhe 40° për këmbë normale. Ekstensioni dorsal, dmth fleksioni i shputës ndaj tibusë, është e caktuar në 5 - 10°. Kjo vendosje mund të duket ekstreme për personat që nuk kanë përvojë me metodën e Ponsetit, megjithatë, është normale dhe esenciale për këtë trajtim. Nëse e shikon gipsin e fundit që e ka pasur fëmija juaj, do të vëreni pozitë të ngjajshme. Gjatësia e ortozës duhet minimalisht t'i përshtatet gjerësisë së supëve të fëmijës suaj. Si fillim tek ortoza BETA-Flex vendoset një sustë jo e fortë. Pasi fëmija juaj të jetë zgjatur dhe forcuar, këtë mund ta zëvendësojë një teknik ortopedik me një ortozë më të fortë.





Çfarë problem mund të shfaqen?

Skuqja dhe shenjat e shtrëngimit: Lëkura e bebeve nuk është ende e forcuar për të mbathur këpucë, që do të thotë që është shumë e ndjeshme. Ndonëse këpucët janë nga një material i butë, ndonjëherë shfaqen shenja të shtrëngimit apo vezikula. Është shumë e rëndësishme që të kujdeseni që këmba është e vendosur mirë në këpucë, si edhe rrëshqitjet e lehta para dhe prapa të këpucës mund të qojnë drejt paraqitjes së shenjave të shtrëngimit. Skuqja që largohet kur këpuca hiqet për një kohë të shkurtër është normale dhe nuk ka arsye për t'u shqetësuar. Megjithatë, nëse të skuqurat rriten dhe marrin ngjyrë më të mbyllur, apo bëhen në formë fluske, konsultohu me mjekun. Ai do të vendosë se si do të jetë procedura e mëtejshme. Nëse nuk ka mundësi tjera, duhet prapë të vendoset gipsi, ku pjesët e dëmtuara të lëkurës mbeten të pambuluara, që të mundësohet shërimi i tyre.

Formimi i mykut: Nëse fëmija juaj ka tendencë të djersitjes së këmbëve, mbajtja e gjatë 23 orë në ditë mund të shpie deri të lagia kontinuale e këpucëve. Nëse përdorni këpucë me veshje lëkure, në raste të rralla kjo mund të shkaktojë myk në pjesën e brendshme të lëkurës, sepse kjo, për të parandaluar alergjitë, nxihet vetëm me substanca bimore. Prandaj, ne rekomandojmë:

- të ajrosen këpucët dy herë në ditë për gjysmë ore
- nëse këmbët janë shumë të djersitura, ndërroni çorapet më shpesh gjatë ditës
- ose të mbani modele këpucësh të veshura me pëlthurë argjendi kundër mikrobeve



Dhe në fund, disa njoftime të rëndësishme...

Sigurimi: Tekniku medicinal duhet t'i ketë fiksuar vidat me një ngjitës special. Megjithatë, kujdesu që vidat të jenë gjitmonë të shtrënguara, në mënyrë që fëmija mos të jetë në rrezik t'i marrë ato t'i fut në gojë dhe t'i gëlltisë.

Këpucët: Ju lutem të keni parasysh që këpucët ALFA-Flex ose COMFOOT nuk janë këpucë normale për ecje. Për shkak të shputës rigjide, jo elastike, e krijuar veçanërisht për përdorim terapeutik, lëkundja normale e këmbës gjatë ecjes është e pamundur. Gjithashtu, shputa (materiali dhe dukja) nuk ofrojnë përputhshmëri të mjaftueshme me disa sipërfaqe të dyshemesë. Për këto arsye, dhe se mbajtja e këpucëve pa ortozën nuk ka efekt terapeutik, fëmija juaj duhet të mbajë këpucën vetëm në kombinim me ortozën.

Veshja: Këpucët ALFA-Flex ose COMFOOT duhet gjithmonë të mbahet mbi çorape. Mundohu që kur t'i mbathësh çorapet të lësh sa më pak rrudha të mundshme, sepse këto mund të shpien deri te shenjat e shtrëngimit. Prandaj, çorapet e thjeshta janë më të pershtatshme se sa ato me dizajne të ndryshme. Gjithashtu, çorapet nuk duhen të jenë të mëdha, që të mënjanohet formimi i rrudhave. Dy modele të çorapeve të reko-manduara, nga firma Sameda, mund t'i bleni nga tekniku i juaj ortopedik.

Mbështjellja e ortozës: Varësisht se sa aktiv është fëmija juaj, ndodh që ju dhe femija të pengoheni nga ortoza. Sapo fëmija juaj fillon të ec këmbadoras apo të ngritet në këmbë me ortozë, mobilet ose dyshemeja e juaj mund të dëmtohen. Kjo mund të bëhet duke përdorur mbështjellësin special ALFA-Flex ose BETA-Flex (e disponueshme përmes teknikut tuaj ortopedik) apo duke përdorur izolues të gypave nga tregu për pajisje

Pastrimi: Ortoza abdukcionale mund të pastrohet pa problem duke përdorur ujë dhe sapun. Ju lutem shmangeni përdorimin e mjeteve pastruese agresive, që mund të dëmtojnë plastikën.

Gjumi: Disa fëmijë zgjohen natën, nëse ortoza është mbështjellur në mbulesë. Është më mirë që fëmijën ta vendosni në një thes gjumi. Për fëmijë më të mëdhenjë, ju lehtëson nëse ortozën e bëni pjesë të rutinës së gjumit. Fëmija juaj do të kërkojë vetë ortozën kur dëshiron të flejë.

Kalendari i ortozës: Që të mesohet fëmija me ritmin e mbajtjes së ortozës, është mirë që të shënoni në kalendar numrin e orëve që e ka mbajtur fëmija ortozën. Për këtë, mund të kopjoni kalendarin mujor nga mbështjellësi dhe të përdorni për muajt tjerë. Apo shkarkojeni kalendarin këtu: <http://www.sameda.de/english> në kategorinë Download/Parents.



Kalendari i juaj i Ortozës Semeda

Sa gjatë e kam mbahtur ortozen ALFA-Flex ose BETA-Flex për këtë muaj:

	prej ... deri ...	prej ... deri ...	prej ... deri ...	Koha totale
1				
2				
3				
4				
5				
E kam plotësuar ...				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
... diçka për çdo ditë!				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				

